



A.nr.679/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.679/2026, të datës 22.06.2026, të parashtruar nga ankuesja B.O, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokate Fatmire Braha nga Vushtrria, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 31.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.679/2026, e datës 22.06.2026, e parashtruar nga ankuesja B.O.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Ref:DS-331/2026, i datës 20.04.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja B.O, (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 20.04.2026, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e shtesës në pagës në emër të përvojës së punës tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa më datë 20.04.2026, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka nxjerr Vendim Ref:DS-331/2026, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankueses. Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 18.05.2026 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve ne Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më Vendimin KA.nr.18/2026, të datës 17.06.2026 është shpall jo kompetente për të vendosur për ankesën e ankueses, duke e bartur lëndën për shqyrtim dhe vendosjen tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të delegimit të kompetencës nga Komisioni i Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka regjistruar rastin e palës ankuese nën shenjë A.nr.679/2026, dhe mbi këtë bazë do të trajtohet ankesa e datës 18.05.2026 e parashtruar nga ankuesja, pranë Komisionit për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Vendimin KA.nr.18/2026 të datës 19.06.2026 të Komisionit të Ankesave të SKGJK-së; Ankesën me numër 09/1034 të datës 18.05.2026 të ankueses pranë Komisionit për Zgjidhje e Ankesave dhe Kontesteve ne

Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin Ref:DS-331/2026 të datës 21.04.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për kompensim e shtesës në pagë në emër të përvojës së punës e datës 20.04.2026 e parashtruar nga ankuesi tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Autorizimin e datës 06.04.2026; Akt Emërimit e datës 22.12.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve është e pabazuar, sepse:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit me Referencë:DS-61-3730 të datës 22.12.2025 është i punësuar në pozitën *Zyrtar Ligjor*, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar pretendon se Vendimi Ref:DS-331/2026 i datës 20.04.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është nxjerr pa ndonjë bazë juridike për shkak që ekziston baza ligjore për kompensimin e shtesës për përvojën e punës për 0.5% sepse kjo është vendosur me Aktgjykimin KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese, Ligjin për Zytaret Publikë dhe Ligjin për Pagat në sektorin publik. Kërkon të aprovohet në tërësi ankesë dhe të bëhet kompensimin nga 0.25% në 0.5% nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publike e në vazhdimësi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuses referuar kompensimit lidhur me përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i*

takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur me pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik dhe se efektet e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimin (pra nga data 28.04.2024).

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitivit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.679/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokate Fatmire Braha;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.